



*Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët, të nxitur nga dëshira për të bashkëpunuar ndërmjet dy palëve për të shprehur dhe garantuar shërbime më cilësore në aspektin shëndetësorë.*

*Palët pajtohen si në vijim :*

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**MES**

***PROLAB MEDICAL CENTER & LABORATORY  
DHE  
SINDIKATA E POLICISË TË KOSOVËS***

## **QËLLIMI**

Prolab Medical Center & Laboratory dhe Sindikata e Policisë së Kosovës (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunim duke e konsideruar këtë bashkëpunim të domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore specifikiisht të **analizave laboratorike** në përputhje me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi

## **FUSHËVEPRIMI**

**Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** njeh vlerën dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Prolab Medical Center & Laboratory.

**Prolab Medical Center & Laboratory** njeh përfitimet e angazhimit me **SPK** duke ofruar shërbimet laboratorike për anëtarët e saj.

3. Për çfarëdo nevoje lidhur me praktikat e bashkëpunimit, palët në këtë marrëveshje do të bashkërendojnë veprimet e tyre me qëllim të arritjes së objektivave të shprehura në këtë marrëveshje

### MËNYRA E KOMUNIKIMIT

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'ia komunikojnë zyrtarët e tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga organi kompetent i palës.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik. Në cdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.

### 3. KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA E MEMORANDUMIT

1. Kjo marrëveshje fillon nga data 21.05.2025 dhe është e vlefshme për periudhën 2 vjeqare, deri me datën 21.05.2027
2. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e kësaj marrëveshje me paralajmërimin paraprak me shkrim jo më larg se 30 ditë para shkëputjes.
3. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
4. Palët bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellët midis tyre.
5. Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me aprovimin me shkrim të palëve.

### HYRJA NE FUQI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS



PROLAB MEDICAL CENTER





Policimi në bashkësi  
Policija u zajednici  
Community policing

Duke punuar së bashku mund ta bëjmë Kosovën vend më të sigurt për të gjithë.

Radeći zajedno možemo učiniti da Kosovo bude sigurnije mesto za zajednice.

By working together we can make Kosovo a safer place for all communities.



**PROLAB**  
MEDICAL CENTER & LABORATORY

**SHËRBIME  
LABORATORIKE**



